

LAURA OLLDASHI
DY GRATË E NJË BURRI

Tregime të zgjedhura

BOTIMET TOENA

LAURA OLLDASHI

DY GRATË E NJË BURRI

Tregime të zgjedhura

BOTIMET TOENA
Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktor letrar: Behar Gjoka

Korrektore letrare: Sonila Kryeziu

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Erdita Oshafi

© e imazhit në kopertinë: @frrrankky_art

ISBN 9789928817235

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha" nr. 71, Tiranë 1023.

Kutia Postare 1420

E-mail: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al/>

Tregime nga libri i parë: "Ātman"

PIKTURA

Ishe veshur ndryshe. Fustanin e bardhë lino, të gjatë. Në mes, rripi i hollë i mblidhte belin. Jaka ishte e hapur dhe i zbulonte supet e imta. Herë pas herë i mbulohehin nga flokët e gjatë dhe të hollë që i binin si litarë. Imagjinonte fëmijërinë e saj, që i lozte në pjesën e dekoltesë sa herë që fuste gishtat tek ondet. Ecte duke tundur veten si një shtojzovalle. I pëlqenin valët që krijonin palat e fustanit. Rrotullohej me tingujt që si pika vese i rridhnin nga mendja. Pastaj ndalonte dhe shikonte qiellin. Kishte dashur të futej atje. Të kthehej në re dhe të shkrihej në lëvizjen e tyre. T'i humbte tokës! Imagjino shpalljen e ikjes së saj në një letër të vjetër ngjitur mbi një shtyllë, apo në raste më dinjitoze, vdekja e saj do të ishte deklaruar mbi xhamat e pistë të dyqanit ku do t'i bënë edhe pazarin e varrimit. Nuk ishte kohë e përshtatshme. Kishte rënë çmimi. Pak kushtonte dhimbja. Vdekja ishte në modë edhe kur jetonim! Të paktë ata që duronin. Imagjino një shifër për vdekjen e saj. Nuk i pëlqeu. Kushton asgjë, më e vogël se jeta. E sponon vdekjen në tjetër kohë, deri atëherë kur të ketë realizuar paktin e një vdekjeje të denjë. Iu duk i komplikuar ky komunikim, pompoz, kur motivi i veshjes së saj me të bardha kishte qenë i thjeshtë: pozim në studion

e një piktori. Meqenëse do të hynte në kornizën nga ku s' do të dilte kurrë, kishte vendosur të prezantohej sa më mirë.

Pak më vonë është shtrirë mbi pëlhurën e bardhë. Pa fustanin e bardhë. Sipër, re të fotografuara, në ikje. Përballë artisti me penelin në dorë pikturon trupin e saj nudo. Herë i hidhte sytë mbi telajon dhe herë mbi atë. I fliste ngadalë kur nuk mundte të kapte dot ndonjë dritëhije të muskujve. “Hidhe vështrimin nga dritarja! Dua profilin tënd me të mirë! Ngrije dorën! Mbështete bindur mbas koke! Lëvizi flokët nga supet! Gjoksi duhet të jetë i lirshëm! Aspak i ngjeshur me tokën, si tule buke. Duhet vetëm ta prek lehtë, që herë pas here të shoh zigzagun e mbështetjes së lëkurës. Beli i ngritur në ajër dhe vithet spositoji sa më larg nga busti! Kofsha e majtë e futur pak më brenda se kofsha e djathtë! Seksi duhet të jetë i dukshëm. Bëj një tjetër provë, të lutem! Si thua, ndoshta është mirë t’i hapësh pak më lehtë këmbët? Të lutem, zgjati natyrshëm gjunjët, edhe gishtat! Jo, shko fshi manikyrin!”

Vajza ngrihet e lodhur nga aty. E detyruar shkon në banjë. Merr pambukun dhe mundohet të heqë smaltin nga thonjtë. I kishte kushtuar 30 euro dhe për kapriçon e artistit duhet t’i fshijë. Por nuk kundërshton. Mbasi i pastron kthehet në dhomë. Kërkon leje për të pirë duhan. Hap çantën dhe merr paketën. I afrohet lakuriq dritares, duke mbështetur cigaren te buzët. Ajri i freskët i prek lëkurën. Piktori vjen dhe ia ndez. Ajo e thith bollshëm. Aq sa ndien parfumin e nikotinës në mushkëri. E mban gjatë brenda vetes si për t’i qetësuar të gjitha zhurmat e orendive. E lëviz trupin majtas-djathtas për ta dërguar në cepat më të thellë të mobilieve. Mjegulla që bën tymi ia mbulon mirë

rrëmujën. Ndoshta ky ishte motivi që pinte cigare: t'i vinte maskë dhimbjes. Pastaj e shfryn me sa fuqi ka dhe e nxjerr nga goja. E shikon si i largohet çalë-çalë. Beze e bardhë e konsumuar nga pesha. Ndoshta edhe ky ishte motivi që pinte cigare: ia merrte dhimbjet dhe ia nxirrte shëtitje.

Ndjek me sy fraksionin e pikës së fundit të tymit, që bie mbi kapelën e një burri tek ecte i shoqëruar nga një qen.

Shkëputet nga vëzhgimi mbi rrugë, sepse mbas veshit ndien puthjen e piktorit. E largon nga vetja dhe i zgjat cigaren. E thith edhe ai, pastaj menjëherë nxjerr tymin. E bardhë. Ajo ia merr duhanin nga dora dhe e vendos mbi buzët e saj. Përsërit ritualin e thithjes sikur donte të dinte në ç'tjetër kapelë do të mbështetet grupi i brengave të reja. Ishte në merak për fatin e tyre. Në ç'të tjera jetë do të hynin?

- "Dua të them që nuk më pëlqen pozimi im!" - flet duke shqepur tegelat e përqendrimit.

Duket sikur jam vetëm formë. M'i dëgjon mendimet kur më pikturon? I njeh ato? Për shembull, unë thitha cigaren dhe ndoqa rrugën që bënte tymi, i cili më pa, më preku në brendësi. U mundua të nxjerrë një pjesë të konsiderueshme të problemeve të mia. Ti i pe?

- Po, i perceptoj! I kuptoj kur mbështet krahët mbas qafe. Si e fsheh mes flokëve, gjoksin. Nuk ke natyrshmëri. Je ushtarë që nuk kërkon të dalë jashtë nga zona komforte e saj. Të sugjerova disa lëvizje edhe në hapjen e kofshëve, por pashë si t'u drejtuan qimet mbi pubis. Gjymtyrët e tua nuk shprehin jetë. Të thashë, të pastrosh smaltin për t'i vënë në gjallëri gishtat. Si tymi i duhanit edhe unë të shoh, por bëj të kundërtën e tij. I lë të flenë brenda teje

problemet dhe mbi lëkurë të sjellë përsosmërinë e çrregullt të bukurisë tënde. Tek - tuk, kur ta lexoj brengën e ngre më sipër ose e ul më poshtë vizën e penelit. Ai i ndjek mendimet e tua.

- Sipas teje spektatori do t'më deshifrojë?

- Edhe këtu perceptimet mbesin individuale. Sa më shumë këndvështrime kërkon të sjellë arti, aq më shumë analizohet.

- Të të kërkoj edhe diçka, - thotë ajo.

Pastaj merr frymë. Rri gjatë në heshtje. Ndez një tjetër cigare. E thith me ngadalë. Vështrimi në rrugë, mbi kapelën e një burri që ecte i shoqëruar nga një mace. Cigarja konsumohet. E hedh në parketin e dhomës dhe e shkel me këmbën e zbathur. Shtrembëron fytyrën nga dhimbja e djegies. Mbështjell krahët për të prekur gjoksin dhe ecën për t'u ulur në karrigen e sallës. Zgjat dorën dhe loz me onden e flokëve. Pastaj, shumë më vonë del zëri i saj; më i pjekur se mosha.

- Dua të më kuptosh. Nuk më shkojnë mirë punët. Nuk i duroj dot dhimbjet. Më kanë pushtuar nga të gjitha anët. Kam menduar seriozisht ta lë botën. Por nuk dua të largohem përgjithmonë. Dua ta vëzhgoj nga larg dhe ajo të më vëzhgojë mua. S'dua as t'i shoh, as t'i kuptoj më dhimbjet e mia. Askush nuk duhet të shohë çfarë mbaj brenda. As unë vetë nuk dua t'i ndiej më. Po më hedh në tokë pesha e tyre. Të lutem, m'i vër në gjumë dhe të lirohem përgjithmonë nga ato. Të shpëtoj, edhe nga ankthi i fatit të tyre. S'do të më interesojë më në ç'kapelë do të ulen. Pikturo imazhin tim më të mirë dhe më lër aty! Më

bëj të përjetshme! Pa moshë. Pa jetë. E ndalur dhe e shtrirë pezull mbi çdo kohë.

- Do të të vras mbasi të të kem pikturuar?

- Jo! Më fut në kornizë kështu siç jam. Me lër të qëndroj aty. Unë nuk kam simpati për këtë botë. Ka kohë që nuk më pëlqen. As njerëzit. Janë të gjithë të çoroditur. Ose ndoshta jam unë?! Më bëj të përjetshme dhe unë bëj të pavdekshëm emrin tënd. Vetëm të kërkoj që, në krahë të pikturës, në çdo vend, në çdo galeri që do të jem, ma lë të ndezur cigaren.

- *Okay*, - tund me mëdyshje kokën piktori, duke imagjinuar kartelat ku shkruhet: “Ndalohet duhani”.

- Do të mundohem të të bëj njësh me pikturën. Mbasi ta kem pikturuar do t’i vë xham kornizës.

Ajo nuk ka më dëshirë ta dëgjojë. Ia vë dorën përpara gojës. Ia merr duart dhe ia vendos mbi gjoks. Ai kërkon ta puthë në buzë.

- Pa prekje buzësh, - i thotë ajo. - Buzët janë të dikujt tjetër.”

Nuk është më aty kur ai i prek kofshët. Nuk është as në çdo centimetër që ai avancon mbi trupin e saj. Kishte mbyllur sytë dhe ishte larguar. Ulur mbi një re, ku zemra edhe trupi dashuronin.

Pesë minuta më vonë shtrihet mbi pëlhurën e bardhë. Cigarja tymoste dhomën. Duart e piktorit i vihen punës. Për herë të parë mbas një kohe të gjatë janë në harmoni. Edhe trupi i saj është i zhdërvjellshëm, i shkëmbyeshëm, i komunikueshëm. Është bërë plastelinë që modulohet sa herë që dëgjon urdhrat e tij. Punojnë mbi një muaj, derisa piktura është gati.

Prezantimi bëhet në galerinë më të ndriçuar të “Palazzo Reale”.

Më në fund brenda një kornize shtrihej ajo. Kishte kohë që nuk pushonte. Ishte momenti i duhur për të fjetur gjumë, për të mos menduar asgjë as për orën që do ta zgjonte, as për zilen që do ta përplaste çdo mëngjes nga komodina as për sharjet e të dashurit: “Ngrihu, dreqi ta marrë! S’e kuptoj xhanëm përse duhet të më zgjosh edhe mua?”

Më vonë do të dilte dielli dhe do të shullëhej. Retë mbi kokë. As pazare s’do të bënte më. As fatura për të paguar. S’do të merakoset as për dietën, për kirurgun plastik, për kremrat e fundit, për palestrën. Nuk do të përgjonte çdo moment telefonin e të dashurit: kush i bëri *like*, me kë po flirton? Pastaj edhe nga kolegët shpëtoi. Nuk i duronte kur i lëpiheshin në fytyrë dhe mbas shpine ndiente dhimbjen. Redaktorit të gazetës do t’ia thoshte në sy që është vetëm një copë mishi dhe pastaj ta pushonte nga puna. Më në fund, “*addio*” metro, njerëz mediokër, egoistë, boshë, injorantë, të mbaruarit e shekullit! Tani, ishte ora e saj. E shtrirë në pikturë. Të gjitha format i shkëlqenin. Trupi i saj qumësht i bardhë. E kishte parë veten një çast, përpara se të mbyllej brenda kornizës. Nuk u kishte besuar syve. S’mund të ishte ajo. Nuk ishte thjesht bukuria, por mrekullia. Dukej në të tjera lartësira.

Piktori e kishte pyetur: - Si të duket?

- Kralneshë, mor burrë! - i ishte përgjigjur.

Ndërsa tani pushonte në një nga muret më të rëndësishme të qytetit. Çmimi i kishte shkuar në stratosferë. I kujtohet pakti që kishte bërë me veten. Do të ikte nga kjo botë kur vdekja e saj të kushtonte më shumë se jeta. Iu kujtua që edhe piktori e kishte mbajtur fjalën. Në krah të majtë ishte korniza ku cigarja tymoste dhe thithte vetveten.

Çdo gjë ishte siç duhej në ditët e para të vjeshtës, një të shtunë, kur hapen dyert e galerisë. Ajo kishte ngritur kokën, kishte nxjerrë dhëmbët me një buzëqeshje që ia rrumbullakoste dukshëm mollëzat. Pendohet që s'ka marrë kremin me vete.

Një burrë i veshur me uniformë prezanton emrat e personaliteteve që hynin në sallë. Dëgjon disa prej tyre. I njihje?! I kishte parë në televizor ose kishte lexuar për to në gazeta. Turpërohet për vetveten që nuk ishte asgjë, thjesht, vajza e pikturës. Të ftuarit do të rrinin me të vetëm dy minuta. Por nuk ka kohë për mendime, spektatorët i kishte përpara. Të parët që i ndalojnë janë një çift i moshuar. Zbrisnin nga një mbretëri, nga një tjetër botë. Ajo, me kapelën e verdhë, mbante për dore të shoqin. Burri dukej sikur kishte ardhur nga vdekja vetëm për ta shoqëruar. Me zë të lehtë i pëshpërit gruas: “Kështu e bukur ishte kur të njoha”. Ajo shtrëngon më fort dorën dhe i skuqen faqet. Burri shikon buzëqeshjen e vajzës së pikturës dhe e përshëndet, siç bëjnë ushtarakët, duke ulur lehtë kokën.

Mbas tyre ndalojnë dy burra të vrenjtur. Njeh presidentin e Amerikës dhe presidentin e Ruisë. Po flisnin me zë të lartë duke lëvizur duart. Hedhin sytë nga piktura. Heshtin. Pastaj Putin thotë: “Bota është si trupi i kësaj femre. E shikon pikën ku është kërthiza? Pikërisht

nga aty deri te koka, bota është imja. Pastaj ju amerikanët, së bashku me Europën, mund ta merrni nga kërthiza deri te këmbët.” A nuk i keni zgjidhur gjërat me anë të seksit? - dukej sikur thoshte presidenti rus. Burri i moshuar, Presidenti i Amerikës, bënte shumë përpjekje që të mbante sytë hapur. Kishte idenë që i flihej. Në atë çast një zë futet në mendimet e zotit Biden dhe i thotë: Ne e dimë që Rusia është e fuqishme. Së bashku me Kinën kanë mjaftueshëm armë bërthamore. Pastaj jemi idiotë që kemi zgjedhur Europën si aleancë që veç di të grijë sallatë.” Një moment hap sytë dhe ngre dorën drejt kolegut:

- E mbyllim këtu pazarin. Nga kërthiza e poshtë është imja.

Putin për herë të parë sheh në sy vajzën e pikturës. I akullt. Ftohtësia e vështrimit futet në të gjithë trupin e saj. Ndalet gjatë poshtë kërthizës. Bashkon buzët fort, sa një gjysmë buzëqeshjeje i shtrydhej mbi fytyrë. Nxjerr gjuhën dhe lëpin lëngun që i rridhte nga buzëqeshja.

- Dakord jam edhe unë! - përfundon komunikimin duke i shtrënguar duart kolegut.

Presidenti i Amerikës largohet nga salla, ndërsa Putin merr në telefon agjentin më të mirë. I kërkon të gjejë informacione mbi modelen, mbi autorin dhe mbi personelin e galerisë. E mbyll telefonatën duke thënë: “Vajzës, në ndonjë vrimë, poshtë kërthizës, futini një çimkë përgjuese!”

Modelja dëgjon të gjithë komunikimin dhe ul duart për të mbuluar dhe zhdukur seksin.

Pastaj përpara pikturës ndalon një tjetër çift. Ai kishte qenë lojtari më i bukur i Anglisë. Ishte folur gjatë për

historinë e dashurisë së tyre, që i kishte rezistuar kohës. Yll ishte akoma. Sikur të mos kishte qenë xhami, vajza do të kishte fluturuar dhe do t'i kishte ndaluar mbi trup. T'ia shqyente smokingun gri. T'ia shihte shpatullat, muskujt e poshtëm të barkut, kofshët. Ta rrotullonte për ta parë të gjithin. Dhe t'i futej? Ku? Në gjoksin e tij...

Ishte nga të paktët burra që i kishte qenë besnik për një vit rresht. Kalendarin e tij e kishte varur në murin e zyrës. Çdo ditë, çdo muaj, ai kishte qenë aty. Vajza me trishtim fut kujtimet brenda kornizës dhe nxjerr buzëqeshjen më të mirë të saj. Beckham e shihte me admirim, sidomos format e gjoksit. I thotë Victoria-s: “Këto janë topa. Edhe sikur gjithë jetën të loz me ato, të forta mbeten. Jo si të tuat.”

- Shpirt, më duhet të fle një javë me gjoksin e modeles dhe të kthej përgjigje. Për momentin kënaqu me portokallet e mia të shtrydhura, - flet zëri i hollë i gruas.

Vajza heq duart nga seksi dhe mbulon gjoksin. Jo, një javë me Victoria-n nuk mundet. Të mos e teprojmë! Është shumë. Imagjinon prekjen e skeletit të duarve anemike: pa mish, të drunjta, të ftohta. Për fat të mirë, Davidit nuk i pëlqeu ideja. E merr për krahu, fijen e spagetit dhe të dy largohen.

Çifti i fundit vinte nga vendi i saj. Ajo nuk studion as individin, as artistin, as politikanin. Thjesht kur shikimet e tyre ndeshen, zmbropset. Shkon mbas murit ku ishte varur piktura. Bën një vrimë dhe fshihet. Kishte vetëm dy duar. Nuk mund të mbulohet e gjitha. Në një tjetër botë, në një tjetër jetë, ai kishte tentuar të abuzonte mbi trupin e saj. Në atë mbrëmje të largët, kur gruaja e individit ishte futur rastësisht në dhomën e errët, ia kishte fluturuar

fjalët si shpulla: “Femër e mallkuar, faji është yti! Përse e provokove?” E gjithë salla “e ndershme” ia kishte shkelur siluetën dhe e kishin dëbuar turpërisht nga ajo tokë që nuk u bë kurrë e premtuar. Kur i sheh përpara vetes dridhet. Plaga i çahet. Në vend që të struket del nga vrima me një forcë të çmendur. Futet në kornizë dhe ngrihet në këmbë. I vihet përballë burrit. Krahët lart i mbështet mbas kokës. Gjoksi varet në lartësinë e buzëve të tij. Mjafton që ai të zgjasë duart dhe t’i prekë kofshët. Burri tenton dhe në heshtje i thotë: “Më thuaj çmimin tënd. Sa lekë do që të jesh imja? Unë të blej”.

Vajza-pikturë i qesh. Ia ulërin buzëqeshjen. Pastaj ia shkërmoq përpara fytyrës duke i thënë: “Ti vjen nga një vend pleshtash. Unë iu shita Amerikës, jam spiune e Ruisë, Kina me mua prodhon viruset. Europa në Francë më ka bërë tritol për armët bërthamore. Dhe ti do t’më blesh? Me lekët që ia vjedh fukarait, popullit tënd. E shndërrove pa dinjitet si vetveten!”

Pastaj zëri i burrit i drejtohet së shoqes: “Na fëlliqi atdheun. Nuk ke ndonjë çarçaf ta mbulojmë?”

Gruaja me mllëf mendon: “E bukur në jetë, e shkëlqyer në pikturë, por dua ta gris, ta shkel me këmbë. Ti s’do të jesh asnjëherë në fantazitë e tim shoqi”. Ndërsa me zë të lartë thotë: “Atdheu më ka mua! Na ka ne që s’ia ulim nderin! Largohen të dy.

Ai përplas derën e germave të fjalës “kurvë”.

Ajo e thërret “kuçkë”.

Ky kishte qenë inaugurimi. Burrat që do të shpëtonin globin, shtetet, popujt e sflitur, i kishin parakaluar përpara. Kishte pozuar ditë me radhë. Shumë herë e kishin marrë me qira për mbrëmje dhe festa të rëndësishme. E njëjta diarre e botës i kishte parakaluar edhe nga mbrapa. Kur jetonte nuk kishte pasur simpati për botën, kurse tani e villte. Mbas shumë vjetësh ekspozimi, mbas një mbrëmjeje, kur kishte mundur të qetësonte kockat dhe veshët nga dërdëllitjet e ditës; në atë mbrëmje kur ishte e bindur që burrat e kishin urryer për zgjuarsinë dhe gratë për bukurinë; në atë mbrëmje kur kupton që bota është tërësisht e mbaruar, e fundosur përfundimisht në errësirën e interesave dhe pakteve të shpirtave mediokër; kur kupton që askujt nuk i plas për individin; në një nga ato mbrëmje kur pastruesja ia freskonte lodhjen duke i fshirë pluhurin; në ato mbrëmje, kur ajo i fliste për jaranin që bëhej tapë çdo natë, i fliste për lodhjen e fëmijëve, që me mundim të madh i çonte në universitet, pikërisht në atë mbrëmje, xhami i pikturës kriset. Vajza - modele merr frymë thellë. Parfumi i parë ishte duhani. Nga korniza që i kishte ndenjur gjithmonë në krah, merr cigaren. E thith gjatë. Pastaj e nxjerr nga polmonet. Vëzhgon rrugën e tymit. Ai e çon në qendër të qytetit, te një lokal. Në krah i ecën lumi. Ulet mbi karrigen. Veshur me fustan lino të bardhë. Përballë i ulet një burrë. Konsumojnë birrën në heshtje. Sytë shihen. Ajo ngrihet drejt tij. Buzët puthen. Kamerieri shton karriget. Vjen “Dashuria”. Kamerieri vendos një tjetër karrige. Ulet “Familja”. Më vonë, kamerieri mbështet rehatllëkun e divanit. Gruaja ka nxjerrë gjoksin dhe i jep qumësht të miturit, ndërsa burri sheh futboll me fëmijën e rritur.

Mbas darkës të dy marrin shkumësin dhe vizatojnë muret e shtëpisë. Në orën 12 të natës dritat fiken. Lumi fle i qetë në krah të tyre. Në fraksione të caktuara të jetës, gruaja fshin me gomë vizën e bardhë të shkumësit. Hap dritaren për të pirë cigaren: ai ka një tjetër dashuri. Në fraksione të caktuara të jetës, burri fshin vizën e shkumësit. Del në dritare për të thithur cigaren: ajo është dashuruar me një tjetër burrë. Dhoma me muret prej shkumësi gjallëron nga zhurma e fëmijëve.

Në orën shtatë të mëngjesit dëgjohej alarmi në galerinë “MoMa” të Nju-Jork. Vinte nga kati i dytë, afër kopshtit të skulpturave. Korniza e varur, bosh, dëgjon dialogun e inspektorit të policisë: “Piktura- vajzë që pozonte prej kaq vjetësh nuk është më. E kanë vjedhur. Çmimi i saj kishte kapur shifra marramendëse.”

Pastruesja mblidhte nga toka xhamat e thyer të kornizës dhe thithte gjysmën tjetër të cigares. Duke murmuritur këndonte: “Eh vika deti mi lale, o tallaz tallaze. Eh se m’ka zon o mi shpirt, sevdaja me plasë”.

Shtator 2021

GJENDJE

... Duhet të kthehem në shtëpi. Ora është 9 e mbrëmjes. Im shoq do të jetë kthyer nga puna. Darka nuk është gati. Do të nxehet. Në mëngjes nuk munda ta nxjerr mishin nga frigoriferi. Ndoshta ndaloj t'i marr një picë te restoranti në fund të rrugës. Ndërsa unë nuk kam uri. Mbushem me thonjtë që ha, me copat e ndërgjegjes që lëkundet nën ndërdyshjen e pikëpyetjes: e drejtë/e gabuar.

Mbi buzë ende qëndron mbështetur puthja. Ngre dorën të prek kufijtë e saj. Vë lapsin mbi të dhe ia vizatoj trupin. Marr gërshtëren dhe e pres duke ndjekur në mënyrë precize vizën që ka lënë lapsi. Mbasi e pres, mbi dorë më bie puthja...

E kuqe?!

E vogël?!

E pafundme?!

Papjekuria rend me vrap dhe këmbëngul që t'ia prezantoj tim shoqi. Pa arsye me vete, hyj në shtëpi. Ndez dritat e vogla, qirinjtë, muzikën me ritmin vrasës të Minës*. Mbush gotat me verën e bardhë. Shkoj në dhomën e gjumit. Hedh dy pika parfumi në cep të veshit. Vesh fustanin e zi që zbulon kurrizin e mëndafshtë. Mbledh ondet që më bien në qafë dhe kthehem në sallon. Me fjalë

solemne i flas Minës* ta ulë zërin dhe duke ngritur gotën shoh tim shoq në sy. I zgjas pëllëmbën e hapur duke i thënë: “Të prezantoj puthjen”. Ai zvogëlon sytë. Rri në mëdyshje pa deklaruar që nuk po kupton gjë. Ndoshta është i uritur aq shumë, sa nuk sheh zbukurimin tim festiv. Por unë jam aty për ta ngulur më thellë thikën. Me zë të qetë i vë sërish përpara syve formën e prerë dhe përsëris: “Të prezantoj puthjen!” Ai pastron zërin nga një kollë e thatë dhe e vjetër. Kruan kokën dhe më thotë: “Jam shumë i lodhur, nervoz. Nuk jam në formë për të të puthur”.

- Jo, jo, nuk kërkoj puthje nga ti. Por, po të flas për tjetër puthje që ka hyrë në jetën time, - ngrej zërin unë.

Ai vazhdon të mos kuptojë. Kruan akoma më shumë kokën. Mendon për lëkundjet e humorit tim. Pa zë, llogarit ditën kur më vijnë menstruacionet dhe po mundohet të gjejë fjalët e duhura për t’më qetësuar. Ngre barkun nga divani për të më puthur. E shtyj nga vetja dhe i them që buzët e mia i puth epshëm dikush tjetër. Prej një viti. “Unë puth buzët e dikujt tjetër, prek trupin e dikujt tjetër. Ai mezi pret t’më mbështjellë në krahët e tij. Nuk llogarit ditët e ciklit tim, as humorin, por më shtrëngon fort derisa futet ëmbël dhe shpërthyeshëm tek unë”. Fjalët e mia mbulojnë qarjet e një epoke krejt tjetër dashurie, të milionave vite më parë, atë të Minës. Shikoj fytyrën e shtrembëruar të tim shoqi. Dhimbja-klithmë i del nga goja në formë jargash, i bie në tokë dhe formon “onnnn” e zgjatuar të ulërimës. Nuk ndalem me kaq. Si fëmijë i hipi sipër ulërimës dhe kërcej në ajër për t’u mbështetur më me forcë mbi të. Përsëris kërcimin disa herë, derisa ulërima shpohet në shumë vrima dhe “oooo”-ja bëhet një iso polifonike. Pikërisht, në atë

moment ia vë në dorë puthjen klandestine. Shoh grushtin që shtrëngohet fort, por nuk arrin ta shkërmoqë. Pastaj nga dera e sallanit hyjnë burra me mantele të zeza, flokë të gjatë fals, krejt të thinjur. Gjykatësit marrin puthjen dhe i bëjnë gjyqin. Dënohet me asgjësim të përjetshëm. Tim shoqi i rritet më shumë barku dhe gjurmët e imazheve të fundit ma pasqyrojnë duke gëlltitur copa vreri dhe duke lexuar gazetën.

Zgjohem qullë në djersë. E shtrirë në krevatin e madh. Im shoq në krahun e djathtë. Ndiej gërhitjen e lehtë të tij. I zgjas dorën dhe ia rrethoj belin, për aq sa mundem. Ai nuk e ndien afrimin e trupit tim. E puth lehtë në cepin e veshit dhe i pëshpëris refrenin e dashurisë sonë: “Të dua më shumë se dje!” Ai ma kthen me tjetër gërhitje. Ngreh lakuriqësinë time nga krevati dhe lëviz me të shpejtë. Ora shënon gjashtë e mëngjesit. Vesh tutat dhe dal nga shtëpia për të bërë pesë kilometrat e vrapit. Trupi futet në errësirën e mëngjesit. Jam veç sensacion i çuditshëm. Herë-herë humb veten. Më harrohet. Më bie diku. Më zhduket identiteti: kush jam?; ku jam?; përse jam?; kush më thotë që jam?

Rris ritmin e vrapit.

I flas vetes: “Mos mendo!” E urdhëroj të qëndrojë mbi të tanishmen, mbi çastin.

E pyes: “Çfarë jam duke bërë tani?”

Përgjigjem me zë të lartë: “Këmba e majtë më mbështetet fort mbi asfalt. E djathta më ngrihet në ajër,

në pritje që të mbështetet në tokë. E majta ulet në tokë. E djathta ngrihet në ajër.”

Sa herë e përsëris këtë veprim?

I numëroj.

“Janë 5500 ngritje të këmbës së majtë dhe 5500 ulje të këmbës së djathtë dhe e kundërta. Janë 30.000 herë marrje fryme. Dhe jam e përqendruar mbi çastin!” - janë fjalët e mia të fundit.

Më duket vetja si ushtarë e Pentagonit. E përqendruar në ato që bëj, aq sa shoh vizën që lë oksigjeni nga hunda drejt mushkërive. Kuptoj që më janë çlodhur trutë (në qoftë se i kam akoma) dhe kthehem në shtëpi. Freskoj trupin ndërsa im shoq është zgjuar dhe ka përgatitur mëngjesin. Kapuçinon me pak kafe. Buka e thekur, e lyer me kos. Mbi to ka mbështetur copat e avokados, të prera hollë. Arrat e qëruara, të shkërmoqura. Pastaj shkëlqimi i bollshëm i mjaltit. Mbi një pjatë tjetër ka qëruar dy kivi, të ndara në feta. Ndërsa vetë po pi kafën e gjatë të ekspresit pa sheqer, duke lexuar gazetën. Në gojë kërcas bukën e thekur, ndërsa këmbët zgjaten për t’i prekur të tizat me të vetmin qëllim që prezenca ime të jetë më e rëndësishme se e gazetës. Pastaj këmbët ecin të vendosura drejt kofshës derisa ai ngre kokën. Më qesh dhe më thotë që kam taktika të sigurta për të pasur suksese të padiskutueshme. U përkëdhelem syve të tij duke i tundur supet ku ndihet triumfi im i djalltë mbi lajmet e ditës. (Triumfoj mbi botën që zhduket. Fitoj mbi klimën globale. Jam më e fortë se lufta në Afganistan. Fitoj mbi ethet hemorragjike të Marburgut. Fitoj mbi zjarret e Siberisë. Triumfoj! Po në ç’ditë jam sot?)

- Ke lëvizur shumë gjatë natës, - më thotë ai.

- S'ka mundësi të kem lëvizur, sepse nuk kam fjetur. Doja të ulja volumin e gërhitjes tënde, por nuk munda. Nuk doja as të të zgjoja. Kisha dëshirë të madhe të bëja dashuri. T'u mbështeta në kurriz, por s'më ndjeve. Topat (e puthjeve) binin, por ti nuk i dëgjoje.

- E ti çfarë bëre pastaj? - më pyet.

- Të tradhtova, të tradhtova, disa herë rresht të tradhtova.

Ai më qesh dhe më afrohet afër hundës.

- Si ishte dashuria me dikë tjetër që nuk ishte unë?

- Hëm! Eksituse, enigmatike, magjike!

- Jam i lumtur për ty.

- Edhe unë për mua.

Pastaj më merr në krahë dhe më ngreh. Koka ime prek tavanin. Më zbret ngadalë dhe zhytet në buzët e mia. Gjen pak ajër për të më pyetur: - Kush puth më mirë?

- Nuk di të zgjedh, - i përgjigjem duke i shkelur syrin.

Më puth akoma, akoma.

“Mundohu të zgjedhësh”, thoshin puthjet e tij.

- Floriri është i çmuar sepse është i paktë në botë, - përgjigjen puthjet e mia.

- Ti je i vetmi person që m'i shkatërron ëmbëlsisht të shtunat.

-Ti je i vetmi burrë që më përgatit mëngjese të mrekullueshme.

- Po, sigurisht, burrë që humb duelet e puthjeve!

- Është mirë të mendojmë me stomak plot dhe jo me puthje, - tallem me të.

- Por këtë s'duhet të ma thotë gruaja ime. Jo, gruaja ime s'duhet të ma thotë. Stomaku më i rëndësishëm se puthjet?!

- Kush të thotë që jam gruaja jote?

E afroj akoma më pranë. Buzët janë aq afër sa të preken, por nuk e puth. E sfidoj me sy, me kokën që lëviz para - mbrapa; djathtas- majtas.

Puthja varet, mollë, në mes...

... Bie zilja e derës. Im shoq ngrihet ta hapë. Kthehet në sallon me zarfin në dorë. Gris cepin e zarfit dhe nga aty dalin fotografitë. Nuk jam afër, por nga larg dalloj copëza të vetes sime. Flokët e verdhë. Buzët e mëdha. Syrin kafe në grimca jeshile. Vetulla e lartë. Pastaj copa të atij. Duart futur në flokët e verdhë. Syri i kaltër mbështetur mbi syrin kafe. Buzë të mbështetura mbi buzët e mia. Shoh vështrimin e tim shoqit, që më pyet se kush është ky. Një moment zmbrespem, pastaj i afrohem. Zmbrespem përsëri dhe vihem në kërkim. Hedh sytë brenda vetes dhe gjej personin më të fajshëm që ekziston. E peshkoj dhe e nxjerr nga trupi. Ia vë përballë tim shoqi.

“Kjo jam unë! Jam unë! Ajo që sheh në foto dhe puth dikë tjetër. Jam unë, por jo gruaja jote. Sepse s’mund të jem gruaja jote kur puth dikë tjetër që nuk je ti. Gjersa nuk je ti, s’mund të jem as unë!” - flet zëri i versionit tim të fajshëm.

Nuk më pëlqen ky variant imi. Nuk kishte karakterin e duhur të situatës. E hedh kuturu në komotë e trupit dhe vihem në kërkim për të gjetur një tjetër prezantim. Hap të gjithë sirtarët e versioneve të mia. Gjej “të pafajshmen”; “bukuroshen e fjetur”. E nxjerr më shumë delikatesë nga vetja dhe e ul në divan.

(Mina vazhdonte akoma të këndonte: donte të kthehej në shtëpi.

- Në cilën shtëpi, Mina, do të shkosh?)

“Bukuroshes së fjetur” ia vendos çelësin në zemër. E kurdis. “Bukuroshja” fillon të ecë.

I merr fotografitë nga duart e tij dhe qesh.

- Sa bukur që puth! Dhe ai mrekullisht, e bën, - tingëllon zëri i saj.

Unë bashkë me tim shoq shqyejmë sytë nga çfarë na dëgjojnë veshët. Ngrihem dhe ia heq çelësin nga zemra. Menjëherë ia spostoj në bravën e trurit. Shpërqendrohet dy minuta, por kthehet shpejt. Me sytë të fiksuar mbi fotografitë i flet tim shoqi:

- “Pse nuk më flet për bionden tënde.? A të kujtohen mbledhjet e gjata të tua, të pafundme? Mendoje që i besoja. Një mbrëmje të erdha në zyrën tënde dhe pashë trupat tuaj që bashkoheshin. Këtu, pikërisht këtu, në zemër perceptova dhimbjen. Perceptoja përmasat si rritej dhe më zinte frymën. Bëhej më e madhe se trupi im. Ti nuk e ktheve kokën të shihje si mbytesha. Atë natë, kur u ktheve në shtëpi, bëre edhe me mua dashuri, duke më thënë që të kisha munguar. Heshta, duke të hapur trupin tim dhe ta vura në dispozicion. Por mendja m’u betua që një ditë do të gëzoj edhe unë të njëjta momente. Ditën e parë që putha dikë tjetër që nuk ishte ti; ditën e parë që bëra dashuri me të, në darkë kur u ktheva në shtëpi të thashë: “Më ke munguar”. U ndjeva mirë nga gënjeshtria. Kërceva brenda vetes nga lumturia e hakmarrjes. Trupat tanë u bashkuan pak më vonë dhe hipokrizia bënte çmendurisht dashuri. Më në fund, e barabartë me ty! E ndien edhe ti dhimbjen, këtu në zemër, që bëhet e padurueshme?

Thirru gjykatësve të mykur nga mediokriteti anadollak i kohës dhe t’u themi të dënojnë tradhtinë time!”

“O Zot! Çfarë po bën ky version i im “i pafajshëm” i “bukuroshes së fjetur”? - flas me vete.

E marr prej flokësh dhe e fus me inat në sirtarët e trupit. Pastaj vrapoj në dhomën e gjumit. Mbush valixhen. Vendos brenda krehrin, furçën e dhëmbëve dhe prerësen e thonjve. Me vështirësi ia mbyll zinxhirin. I ulem sipër. Nga ajri vijnë muskujt - karate të tim shoqi. Valixhja bëhet qilim dhe të dyja fluturojmë nga dritarja.

Zgjohem, sërish qull në djersë. Kam zënë vetëm një copëz të vogël të krevatit. Pjesa më e madhe i takon atij. Ai gërhet lehtë. Është muzikë e ëmbël për veshët. Ora shënon gjashtë e gjysmë. Ngrihem. Përgatitem ngadalë duke filluar nga ushtrimet fizike për të forcuar muskujt e barkut. Ndez makinën e kafes. Pastaj radion. Filloj të bëj tualet. Dëgjoj nga larg zgjimin e tim shoqi, që vjen nga banja tjetër. I zhurmshëm aq sa s’më lë të dëgjoj horoskopin. Më vjen në mendje miku im që vdiq javën që shkoi. Ishte i shenjës së demit. E di që nuk ka kuptim, por jam kurioze të dëgjoj horoskopin e tij. “Do të jesh nervoz sot. Tension i madh në punë, duhet të kesh kujdes me lekët dhe në dashuri!”, - flet zëri i ëmbël i prezantueses.

(I shkoi mirë këtë herë që nuk do ta jetojë ditën mes bërrylave të kolegëve dhe varfërisë shpirtërore moderne, teknologjike, globale.)

- Kafeja gati, - më thërret im shoq.

- Erdha, - përgjigjem e inatosur që më ndërpreu mendimet.

E gëlltis për një fraksion sekondi.

- Ke lëvizur prapë këtë natë, - më thotë ai.

- Sipas teje, njerëzit që vdesin kanë horoskop? - ia kthej unë.

- Çfarë të ndodh? - habitet.

E puth dhe shkrihem në krahët e trupit të tij të madh.

- Të dua, të dua më shumë se dje. Kjo më ndodh! - i përgjigjem.

Largohem më shpejt se fjalët “të dua edhe unë” të thëna nga ai.

- Shihemi në darkë. Do të vonohem sot. Kam mbledhjen e fundit të vitit, - i them para se të mbyll derën.

Hipi në makinë. Lëviz timonin pa qenë prezent në gjërat që bëj. Nuk shoh as semaforin që është i kuq. Frenoju me shpejtësi.

“Kthehu këtu!” - i them vetes.

Bie zilja e telefonit. Nuk i përgjigjem. Arrij në punë. Im shoq më shkruan disa herë. I dërgoj mesazhe me ikona të qetësisë së dashurisë sime. Dita më ikën nga njëra mbledhje në tjetrën. Në orën katër dal nga puna dhe prezantohem në takim. Pasditet ishin ende me dritë. Rrugët plot me makina. Ngjis ashensorin në katin e gjashtë. Pres të më hapet dera. Një zë burri më thërret të hyj në dhomën e errët. Është ulur mbi poltronin ngjyrëkafe, prej lëkure. Moshë e mesme. Flokët e bardhë kanë filluar t’i lulëzojnë. Mjekra ia zgjat më shumë fytyrën.

- Uluni, - më flet lehtë.

I ulem përballë. Më pyet për emrin dhe për moshën.

- Jeni e martuar?

- Po, - përgjigjem.

- Përse jeni këtu?

- Është pak e vështirë t'ju shpjegoj. Ndoshta, është histori e gjatë, ndoshta nuk është as histori. Kam pesë vjet e martuar. Im shoq është dashuria ime. Është ajo figurë që e ke njohur gjithmonë edhe përpara se ta takosh. Si në filma, që e sheh nga larg dhe thua: "Ai është burri i jetës sime". Dhe ashtu ndodh. Pa asnjë lodhje, pa asnjë mundim historia pikturohet vetë dhe pa kuptuar kalojmë bashkë vite të shkëlqyera. Është gjithmonë aty ku unë dua të jetë, ka gati përgjigjen më inteligjente që ekziston. Është i bollshëm në shpirt, i gatshëm për të lehtësuar dhimbjet e mia, për t'mi realizuar të gjitha kapriçot. Dashuron karakterin tim të pagdhundur, tekat e fëmijës që flenë tek unë, heshtjet e gjata, luhatjet e humorit. Shënon në kalendar ditët e menstruacionit dhe atë javë unë jam mbretëresha e sëmurë. Pastaj puth bukur. Është i bukur. Është i tërë, i bukur. Në qoftë se do t'më pyesësh, po të kthehem mbrapsht, zgjedhja do të jetë gjithmonë ai. Me pak fjalë, jam e lumtur.

- Nuk kuptoj. Çdo gjë është perfekte, - më ndërpret psikologu. - Ku është problemi?

- Problemi është që kjo gjë më ndodh ditën, ndërsa natën, në ëndrra e tradhtoj. Kam një tjetër histori. Nuk është vetëm kjo gjë, por kam një sjellje çmendurisht të pashpirt me të. Duket sikur kam thikën në dorë dhe ia shkarravis plagët ngadalë. I qesh duke ia shkelur dhimbjet poshtë

këmbëve. Rënkimi i tij më argëton. Pastaj kur zgjohem në mëngjes, e dashuroj edhe më shumë.

- Është normale që në mëngjes e dashuron, sepse ndihesh në faj. Por doja t'ju pyesja, në të vërtetë ju e tradhtoni bashkëshortin?

- Nga ta di kur nuk kuptoj kush jam? Kush më thotë që ëndrra nuk është realitet dhe realiteti nuk është ëndërr? Siç thashë, jam e dashuruar me tim shoq, por në qoftë se takimin me ju, psikolog, do ta bëja në orët e gjumit, do t'ju thosha se, si unë, ashtu edhe burri im, e tradhtojmë njëri-tjetrin.

Ai heq syzet. Merr pecetën për t'i pastruar. E gjithë koha është në dispozicionin e tij. Dua t'ia deshifroj mendimin, por më lë heshtjen. Pritja më duket e pafundme. Koha ime është e çmuar. Nuk e kam nxjerrë mishin nga frigoriferi. Ngre gishtat dhe filloj të ha thonjtë. Bëj plane për të blerë picën në restorantin në fund të rrugës. Javën që shkoi vdiq miku im më i mirë. A kanë horoskop të vdekurit? Nuk kemi më katër stinë, por vetëm dy: të punës dhe të gjumit. Grupi po eliminohet. Jemi vetëm. Kabuli u pushtua përsëri mbas 20 vjetësh. Dështoi misioni i amerikanëve, i evropianëve, i iranianëve, i pakistanezëve. Përse ikën ndërkombëtarët nga Kabuli? Përse i tradhtojnë popujt? Ndërsa gjykatësit dënojnë puthjen me vdekje! Vendi më i ftohtë në botë, Siberia, po digjet. Ndërsa rrebeshet morën gjysmën e ballkonit tim. Në Haiti vdiqën 1500 persona nga tërmeti. A është plakur toka? Ku do t'i mbështesim këmbët? Ethet hemorragjike të Marburgut janë më vdekjeprurëse se të Covid-it...

Përse na japin kaq shumë informacione kur nuk jemi në gjendje t'i zgjidhim?!

- Ju ka tradhtuar bashkëshorti? - më ndërpret psikologu.

Gusht 2021

**Mina me këngën "Devo tornare a casa mia".*